

VENDIM
Nr.470, datë 23.6.2005

**PËR DHËNIE FONDI SHOQATËS SË INVALIDËVE PARAPLEGJIKË DHE
TETRAPLEGJIKË TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve të Shqipërisë t’i jepet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano